

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-276/13

Prishtinë

9 Qershor 2015

Në çështjen juridike të:

O. A.

Mitrovicë

Pala ankuese

vs.

N/A

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/ R/199/2013 të datës 18 prill 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00447), pas shqyrtimit të mbajtur më 9 Qershor 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e O. A. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/ R/199/2013 të datës 18 prill 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00447).
2. Vërtetohet vendimi KPCC/D/C/ R/199/2013 i datës 18 prill 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00447).

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 28 shkurt 2007 O.A. (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtës së bashkëpronësisë lidhur me pronën që ndodhet në Mitrovicë. Paraqitësi i kërkesës nuk e ka saktësuar numrin e ngastrës të pronës së kërkuar por nga dokumentet që ishin dorëzuar dhe hulumtimi i bërë nga AKP-ja rezulton se prona është pjesë e ngastrës nr. 19 në Zonën Kadastrale të Mitrovicës. Pjesa kryesore e pronës shfrytëzohet nga shkolla fillore "Sveti Sava". Pjesa e kontestuar e pronës është rezidenciale, shtëpi me sipërfaqe prej 71 m² dhe oborr me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.04.05 ha. Paraqitësi i kërkesës theksoi se posedimi mbi pronën ishte humbur më 13 maj 1999 për shkak të konfliktit të armatosur në vitin 1998/1999 dhe se prona është uzurpuar ilegalisht nga shkolla fillore "Sveti Sava". Gjithashtu, paraqitësi i kërkesës theksoi se ai ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale të Mitrovicës lidhur me çështjen e njëjtë.
2. Së bashku me kërkesën A. kishte dorëzuar në mes tjerash edhe dokumentet vijuese:
 - Aktgjykimin GZ.138/2006 të datës 9 nëntor 2007 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë përmes të cilit është vërtetuar se paraqitësi i kërkesës dhe motra e tij janë bashkëpronar të pronës së kërkuar me ½ pjesë të barabarta si trashëgimtar të babait të tyre të ndjerë, A. A. prandaj Komuna e Mitrovicës është e obliguar të njoh të drejtën e bashkëpronarëve dhe të lejoj regjistrimin në librat kadastral. Në arsyetim të

Aktgjykimit theksohet se në vitin 1960 babai i ndjerë i paraqitësit të kërkesës kishte marrë pronën e kërkuar si dhuratë nga pronari i mëparshëm K. M.; dhe se ai kishte ndërtuar shtëpinë dhe kishte jetuar në të njëjtën me familjen e tij deri në vitin 1999 kur shtëpia e kërkuar ishte djegur për shkak të konfliktit të armatosur; dhe se familja ishte zhvendosur në Novi Pazar. Në pronën në të cilët më parë kishte qenë shtëpia ishte ndërtuar një palestër. (Padia lidhur me të cilën aktgjykimi i përmendur ishte lëshuar, është paraqitur në Gjykatën Komunale të Mitrovicës në vitin 2004).

- Vendimin Kadastral 516/2010 të datës 4 maj 2012 të lëshuar nga Komuna Kadastrale e Mitrovicës përmes së cilit është miratuar kërkesa e paraqitësit të kërkesës për sa i takon ndarjes dhe regjistrimit të drejtës së bashkëpronësisë mbi pronën e kërkuar dhe paraqitësi i kërkesës ka regjistruar bashkëpronësisë e tij në Regjistrin e Pronës së Paluajtshme në bazë të dispozitivit të Aktgjykimit C.No.463/2004 dhe Aktgjykimit GZ.138/2006.
3. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së konstaton se paraqitësi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për të njëjtën pronë në Komisionin për Kërkesa Pronësore Banësore (KKPB) duke kërkuar ri-posedimin.
 4. Me vendimin e tij grupor HPCC/D/163/2004/C të lëshuar më 9 dhjetor 2004, Komisioni për Kërkesa Pronësore Banësore ka lëshuar urdhrin për ri-posedim. Neni 6 i Vendimit Grupor e saktëson se urdhri zgjedh vetëm çështjen e të drejtës ndaj vendimit deklarativ të miratuar. Ai nuk vendos përfundimisht ndonjë të drejtë tjetër ligjore, çështje apo kontest që ndërlidhet me pronën e kërkuar.
 5. Më 11 maj 2011, Ekipi për Njoftim i AKP-së kishte shkuar në pronë dhe kishte vendosur një shenjë duke e bërë kështu njoftimin e kërkesën. Në raportin e saj njoftues, Ekipi i AKP-së theksoi se prona ishte kopsht dhe një pjesë e palestrës së sporteve e cila ishte zënë nga Shkolla Filllore "Sveti Sava". Drejtori i shkollës nuk kishte pranuar të jetë pjesë e procedurës së AKP-së. Pasi që nuk ishte paraqitur asnjë njoftim mbi pjesëmarrjen, kërkesa mbeti e pakontestuar.

6. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së të datës 1 shkurt 2013, ishte konstatuar se prona ishte e regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës si bashkëpronar me 1/2 pjesë ideale. Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë i Komunës së Mitrovicës, në përgjigjen e vet me shkrim nr. 15-031-971/13 të datës 24 janar 2013, e vërtetoj se ngastra nr. 19 ishte regjistruar nën emrin e Asamblesë Komunale deri në vitin 2012, ndërsa bazuar në Aktgjykimin GZ.138/06 të datës 09.11.2007 ngastra ishte ndarë dhe ishin krijuar ngastra të reja sikur ngastra nr. 19/1, e cila ende evidencohet në emër të Komunës dhe ngastra kadastrale nr. 19/2 e cila ishte e evidencuar nën emrin e O. A. dhe E. S.
7. Më 18 prill 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e saj KPCC/D/R/2013, i ishte referuar vendimit paraprak të KKPB-së dhe kishte hedhur poshtë kërkesën për shkak të *res judicata* duke theksuar se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka në posedim të saj prova domethënëse të cilat ose janë dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose janë siguruar *ex officio* dhe që dëshmojnë se kërkesa është shqyrtuar më herët dhe për të është vendosur përmes një vendimi final administrativ ose gjyqësor.
8. Më 12 gusht 2013, Vendimi i ishte dorëzuar O. A. Ai kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme me datën 3 shtator 2013 (në tekstin e mëtejme: pala ankuese).

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese pretendoi se ai jeton në kushte të vështira sociale dhe financiare në shtëpinë e marrë me qera prandaj ai kërkon nga Gjykata Supreme të ndërtoj një shtëpi për të dhe familjen e tij. Në ankesë A. jep përshkrim detal të dokumenteve që ai kishte dorëzuar për të vërtetuar të drejtën e tij të bashkëpronësisë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit 30 ditësh që parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Meritat e ankesës

11. Pas shqyrtimit të shkresave të dosjes dhe pretendimeve të palës ankuese, në përputhje me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
12. Në rastin aktual, nga dosja e çështjes është konstatuar se pala ankuese para Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB) kishte kërkuar ri-posedimin mbi shtëpinë e cila ishte shkatërruar gjatë konfliktit të armatosur dhe KKPB me vendimin e saj grupor HPCC/D/163/2004/C kishte lëshuar urdhrin për ri-posedim duke saktësuar se urdhri zgjidhte vetëm çështjen e së drejtës ndaj vendimit deklarativ të miratuar; megjithatë ai nuk vendoste përfundimisht ndonjë të drejtë tjetër ligjore, çështje apo kontest që ndërlidhej me pronë e kërkuar. Çështjet e *res judicata* mund të shfaqen lidhur me vendimet e mëhershme të KKPB-së aty ku KKPB më herët ka vendosur të drejtën e pronësisë mbi pronën lidhur me ndonjë kërkesë dhe aplikohet vetëm lidhur me të njëjtën ose në thelb të njëjtin grup faktesh. Ky nuk është rasti këtu për sa i takon vendimit të përmendur të KKPB. Ndryshe nga KKPK, Gjykata Supreme nuk mbështetet në vendimet e mëhershme të KKPB-së për sa i takon meritave të kërkesës aktuale të pronësisë.
13. Megjithatë, pala ankuese, kur kishte bërë kërkesën në AKP e kishte përmendur se ai tanimë kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë i cili ishte bërë i plotfuqishëm me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut lidhur me lëndën e njëjtë. Ai ka paraqitur Aktgjykimin AZ.138/2006 të datës 9 nëntor 2007 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë që tashmë e kishte vendosur çështjen e njëjtë mbi meritat. Çfarë

- është më e rëndësishme, pala ankuese e kishte regjistruar të drejtën e tij të bashkëpronësisë (1/2 e pjesës ideale) mbi ngastrën nr. 19 në kadastër me ndarjen e ngastrës së kërkuar në dy pjesë si parcela nr. 19/1 dhe 19/2. Aktgjykimi në fjalë ishte ekzekutuar dhe tanimë ishin bërë ndryshimet e nevojshme në kadastër lidhur me pronësinë. Ngastra nr. 19/2 tashmë është e regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës në bazë të aktgjyqimit të plotfuqishëm të lartpërmendur.
14. Sipas nenit 11.4 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 KKKPK hedh poshtë kërkesën kur kërkesa është shqyrtuar dhe vendosur më parë me vendim të plotfuqishëm të gjykatës. Prandaj, Gjykata Supreme thekson se kërkesa duhet të hedhet poshtë si çështje *res judicata* jo për shkak të vendimit të KKKPB-së siç ishte cekur nga KKKPK-ja por për shkak të Aktgjyqimit GZ.138/2006 të datës 9 nëntor 2007 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë i cili ishte ekzekutuar tanimë (shih paragrafët e mësipërm 6 dhe 13).
15. Prandaj, vendimi i apeluar nuk përmban asnjë shkelje thelbësore dhe as zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe asaj procedurale.
16. Për sa i përket kërkesës së palës ankuese për ndërtimin e një shtëpie për të, Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme nuk ka juridiksion mbi një kërkesë të tillë prandaj kjo kërkesë hidhet poshtë.
17. Në bazë të arsyetimit të mësipërm dhe sipas dispozitave të nenit 13 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

18. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman NUREDINI, Kryetar i Kolegjit

Willem BROUWER, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus BRUIN, Gjyqtar i EULEX-it

Urs NUFER, Referent i EULEX-it